



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gazetari**

Lënda: Praktikë në media 4

<i>Pedagogu:</i>	Andi TELA
<i>Ngarkesa:</i>	1 ETCS (15 javë: 1leksion në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Viti/semestri:</i>	II/II

Përshkrimi: Tu ofrojë studentëve përmes leksioneve dhe orëve praktike mënyrën e organizimit të punës në një gazetë. Objekt i këtij kursi është edhe organika e një gazete të përditshme, verifikimi i burimit të infomacionit dhe vlerësimi i tij. Si bëhet ndarja e faqeve të një numri gazete dhe kriteret për mbulimin e hapësirave. Vendosja e titujve, përmasat dhe vlerat e tyre si dhe cilat janë raportet hierarkike në një të përditshme.

Temat e leksioneve:

- 1. Shtypi.** Raporti i gazetës me mjetet e tjera të informacionit. Sa e përballon ajo konkurrencës e televizioneve dhe internetit. Mutacionet që ka pësuar shtypi me kalimin e viteve dhe cilat janë mënyrat e reja të përshtatjes me tregun.
- 2. Redaksia** si “kuzhina e gazetës”. Si organizohet puna në të.
- 3. Struktura dhe zhargoni** i përdorur në redaksi, përse termat kryesorë janë të huazuara nga italishtja.
- 4. Shkallwt hierarkike.** Roli i drejtorit, kryeredaktorit, redaktorëve, gazetarëve, të dërguarve specialë, korrektorëve, faqosësve dhe ndërlidhja mes tyre. Cilat janë përgjegjësitë dhe detyrat
- 5. Raporti mes faqeve.** Pjesa që zë politika, aktualiteti, kronika, ekonomia, socialja, kultura, sporti, dosieri. Raportet e punës në një ditë rutinë punë dhe në një ditë speciale.
5/1 Kursi ndahet në dy grupe të barabartë. Secili prej tyre ka nga një redaktor. Studentët përgjatë një jave duhet të përzgjedhin nga tre tema për secilin grup. Në vlerësimin e tyre këto tema mund të jenë argumenta për tu pasqyruar në një gazetë të përditshme.
- 6. Përgatitja e një faqe gazete.** Çështë menaboja (projekti grafik). Rëndësia e parapërgatitjes grafike të gazetës. Raportet mes titujve, teksteve dhe fotove. Madhësia e gërmës dhe fondi i përdorur për titujt dhe ndryshimet mes teksteve (korsiv,bolt...)
- 7. Pwrgatitja e njw artikulli.** Si trajtohet një lajm në këndvështrime të ndryshme. Përgatitja e një artikulli, si verifikohet burimi i gazetarit nga redaktori dhe gabimet që duhen evituar. Vlera e fjalisë së parë.
- 8. Arkivi, shembull.** Si përgatitet dhe si ruhet arkivi i një gazete. Vlera e konsultimit të përditshëm të tij. Dy mënyrat e ngritjes dhe mirëmbajtjes së arkivit të një redaksie dhe atij personal për gazetarin.
- 9. Komunikatat e shtypit.** Kush merret në redaksi me komunikatat e shtypit. Si zbulohet lajmi në një komunikatë dhe si duhet shmangur përdorimi i gjuhës zyrtare në tekstin që do të hidhet në gazetë.
- 10. Redaktori.** Roli i redaktorit në një gazetë të përditshme. Si organizon punën me vartësit e tij. Raporti me kryeredaktorin. Ndarja e detyrave dhe kërkesa e llogarisë. Redaktimi i shkrimeve përpara faqosjes.

11. **Korespondentwt** dhe vlera e tyre në një gazetë kombëtare. Si organizohet puna me ta dhe si ngrihet raporti me redaktorin e rretheve.

12. **Simulim.** Studentët raportojnë për punën e kryer gjatë javës së fundit. Në klasë simulohet raporti mes redaktorit dhe gazetarit në raportin e lajmit. Redaktori vendoset përballë gazetarit dhe ndërtohet dialogu pyetje-përgjigje. Ndërrohen rolet. Studentët e tjerë mund të ndërhyjnë me radhë për të sugjeruar pyetje.

13. **Praktikw**

14 **Pwrmbledhje**

15 **Detyra vlerwsimi.** Kontroll me shkrim për leksionet e dhëna gjatë këtij semestri.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- *Detyrim frekuentimi në:70%* të seminareve

- *Angazhimi në seminare:*

20% e notës

- *Detyra I:* në javën e 6-të

30% e notës

- *Detyra II:*në javën e 12-të

50% e notës

- Gjithsej:

100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. Bill Kovach & Tom Rosenstiel, Elementët e gazetarisë, Botimi i ISHM, Tiranë 2009

2. Claude-Jean Bertrand, Deontologjia e mediave, Botim i ISHM. Tiranë 2006

Literatura plotësuese:

1. Furio Colombo, Lajmet e fundit mbi gazetarinë, Botim i ISHM, Tiranë 2008

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc Dr. Mark Marku

Tiranë, 2016